



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2023 – Numri: 45

Tiranë – E hënë, 20 mars 2023

PËRMBAJTJA

		Faqe
Dekret i Presidentit nr. 40, datë 17.3.2023	Për dhënie të shtetësisë shqiptare.....	4959
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 157, datë 17.3.2023	Për propozimin Kuvendit për emërimin e disa anëtarëve të Këshillit të Statistikave.....	4959
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 158, datë 17.3.2023	Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit “Rikonstruksioni i linjës 35 kV Korçë–Bilisht”.....	4959
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 159, datë 17.3.2023	Për miratimin e formës e të përmbajtjes së dokumentit të udhëtimit për të huajt pa shtetësi, të dokumentit të udhëtimit, lejes së kalimit, të dokumentit të përkohshëm, dublikatës së lejes së qëndrimit e të lejes unike, si dhe të letërnjoftimit për të huajt.....	4963
Udhëzim i Këshillit të Ministrave nr. 1, datë 17.3.2023	Për miratimin e metodologjisë për llogaritjen e çmimit mesatar të shitjes së banesave në treg.....	4969
Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 134, datë 10.3.2023	Për miratimin e rregullores “Mbi pikat e referencës për veprim për substancat farmakologjikisht aktive të palejuara të pranishme në ushqimet me origjinë shtazore”.....	4973
	Kërkesë për shpalljen të zhdukur të shtetases Mariela Puka.....	4981



DEKRET
Nr. 40, datë 17.3.2023

PËR DHËNIE TË SHTETËSISË
SHQIPTARE

Në mbështetje të nenit 92, shkronjës “c” dhe nenit 93 të Kushtetutës, si dhe të nenit 6, nenit 8, nenit 20 dhe në vijim, të ligjit nr. 113/2020, “Për shtetësinë”, me propozim të ministrit të Brendshëm,

DEKRETOJ

Neni 1

Dhënien e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të tyre, personave të mëposhtëm:

1. Nderim Skënder Lalaj
2. Sawsan Hatem Shehab

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

PRESIDENT I REPUBLIKËS SË
SHQIPËRISË
Bajram Begaj

VENDIM
Nr. 157, datë 17.3.2023

PËR PROPOZIMIN KUVENDIT PËR
EMËRIMIN E DISA ANËTARËVE TË
KËSHILLIT TË STATISTIKAVE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 22, të ligjit nr. 17/2018, “Për statistikën zyrtare”, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Propozimin Kuvendit për emërimin e disa anëtarëve të Këshillit të Statistikave, si më poshtë vijon:

a) Z. Adrian Kamenica, përfaqësues i përdoruesve kryesorë të statistikave zyrtare;

b) Znj. Elora Kokalari, përfaqësuese e përdoruesve kryesorë të statistikave zyrtare;

c) Znj. Kozeta Sevrani, përfaqësuese e botës akademike;

ç) Z. Edvin Zhllima, përfaqësues i shoqërisë civile;

d) Z. Blendi Salaj, përfaqësues i medias.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

VENDIM
Nr. 158, datë 17.3.2023

PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES
PUBLIK, TË PRONARËVE TË
PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË
PRIVATE, QË PREKEN NGA
REALIZIMI I PROJEKTIT
“RIKONSTRUKSIONI I LINJËS 35 kV
KORÇË-BILISHT”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, të ndryshuar, dhe të nenit 13, të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001, “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar, me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe ministër i Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit “Rikonstruksioni i linjës 35 kV Korçë-Bilisht”.

2. Shpronësimi bëhet në favor të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes sh.a.

3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, pronë private, që shpronësohen, kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse, që paraqitet në tabelën që i bashkëlidhet këtij vendimi, për pasuritë e llojit “arë”, “truall” dhe “vreshta”, me një vlerë të përgjithshme prej 700 285 (shtatëqind mijë e dyqind e tetëdhjetë e pesë) lekësh.

4. Vlëra e përgjithshme e shpronësimit, prej 700 285 (shtatëqind mijë e dyqind e tetëdhjetë e pesë)



lekësh, përballohet nga Operatori i Sistemit të Shpërndarjes sh.a.

5. Vlera e shpenzimeve procedurale, në masën 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë, përballohet nga Operatori i Sistemit të Shpërndarjes sh.a.

6. Shpronësimi fillon menjëherë pas botimit të këtij vendimi në Fletoren Zyrtare dhe afati i përfundimit të shpronësimit është brenda 3 (tre) muajve nga data e hyrjes në fuqi të tij.

7. Pronarët e pasurive të paluajtshme, pronë private, të pasqyruar në tabelën që i bashkëlidhet këtij vendimi, kompensohen për efekt shpronësimi, pasi të kenë paraqitur dokumentacionin justifikues për likuidim pranë Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes sh.a.

8. Operatori i Sistemit të Shpërndarjes sh.a., kryen procedurat për likuidimin e pronarëve të shpronësuar, sipas përcaktimeve të bëra në këtë vendim.

9. Afati i fillimit dhe i përfundimit të punimeve është në përputhje me afatet e parashikuara nga Operatori i Sistemit të Shpërndarjes sh.a.

10. Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Korçë dhe Zyra Vendore Devoll, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e miratimit të këtij vendimi, nisin procedurat për hedhjen e gjurmës së projektit mbi hartën kadastrale, sipas planimetrisë

së shpronësimit të miratuar, dhe regjistrojnë aktin e kalimit të pronësisë për pasuritë e shpronësuara në favor të shtetit në përgjegjësi administrimi të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes sh.a.

11. Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Korçë, dhe Zyra Vendore Devoll pezullojnë të gjitha transaksionet me pasuritë e shpronësuara, deri në momentin e realizimit të procesit të hedhjes së gjurmës së projektit mbi hartën kadastrale dhe regjistrimit të aktit të kalimit të pronësisë në favor të shtetit në përgjegjësi administrimi të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes sh.a., për pasuritë e shpronësuara.

12. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Operatori i Sistemit të Shpërndarjes sh.a., Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Korçë dhe Zyra Vendore Devoll, Agjencia Shtetërore për Shpronësimin dhe Drejtoria e Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës pranë Këshillit të Qarkut Korçë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR

Edi Rama



LISTA EMËRORE E PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË SHPRONËSOHEN, PËR INTERES PUBLIK, NGA REALIZIMI I PROJEKTTI "RIKONSTRUKSIONI I LINJËS 35 kV KORÇË-BILISHT"

Nr.	PRONARI			TË DHËNA HIPOTEKORE										VLERËSIMET PËR SHPRONËSIM													SHËNIME <i>(Kufizime hipotekore, burrë mbi pasurinë etj.)</i>
														"ARË"			"TRUALL"			"NDËRTESE"			Vlerat e kulturave bujqësore dhe dru-frutoresh sipas proces-verbalit të Drejtorisë së Bujqësisë		VLERA TOTALE (lekë)		
	Sipërfaqja (m ²)	Çmimi (lekë/m ²)	Vlera (lekë)	Sipërfaqja (m ²)	Çmimi (lekë/m ²)	Vlera (lekë)	Sipërfaqja (m ²)	Çmimi (lekë/m ²)	Vlera (lekë)	Vlera e kulturës bujqësore (lekë)	Vlera e dru-frutoresh (lekë)																
	A	B	C	C	D	E	F	G	H	I	J	K	L	M	N	O	P	Q	R	S	T	U	V	Y		Z	
Bashkia Korçë A.S.H.K. Korçë																											
NB Korça																											
1	Doloreza	Ferid	Hoxhallari	"	8561	9/288	Truall	482		482						49	8537	418,313							418,313	Konfirmuar nga ASHK-ja	
2	Musa	Ramadan	Kalermi	"	8561	8/338	Arë	863	863				72	100	7200										7200	Konfirmuar nga ASHK-ja	
3	Bujar		Qamri	"	8561	10/47	Arë	2816	2816				42	100	4200										4200	Konfirmuar nga ASHK-ja	
Barç																											
4	Tushe	Refik	Likollari	"	1101	214/21	Arë	3900	3900				30	100	3000										3000	Konfirmuar nga ASHK-ja	
5	Spiro	Jorgo	Ziko	"	1101	214/8	Arë	3521	3521				30	100	3000										3000	Konfirmuar nga ASHK-ja	
6	Hekuran	Nexhip	Dapellari	"	1101	695/6	Arë	4495	4495				30	100	3000										3000	Konfirmuar nga ASHK-ja	
7	Yrmet	Asllan	Xhakolli	"	1101	202/28	Arë	2000	2000				30	100	3000										3000	Konfirmuar nga ASHK-ja	
8	Hysen	Hasan	Ceko	"	1101	201/13	Arë	7268	7268				30	100	3000										3000	Konfirmuar nga ASHK-ja	
9	Qemal	Xhevdet	Dedelli	"	1101	200/1	Arë	3738	3738				49	100	4900										4900	Konfirmuar nga ASHK-ja	
Dishnicë																											
10	Defrim	Mustafa	Preso	"	1491	69/8	Arë	4423	4423				30	170	5100										5100	Konfirmuar nga ASHK-ja	
11	Dhori	Thomas	Androllari	"	1491	71/23	Arë	1485	1485				30	170	5100										5100	Konfirmuar nga ASHK-ja	
12	Vaglin	Shaban	Alimi	"	1491	72/5	Arë	1356	1356				36	170	6120										6120	Konfirmuar nga ASHK-ja	
Nevësisht																											
13	Neshdet	Tefik	Xhaballi	"	2783	271/88	Arë	937.55	937.55				36	100	3600										3600	Konfirmuar nga ASHK-ja	
14	Anila Elvi	Muhamer Gjergji	Agolli	"	2783	271/73	Arë	2480	2480				36	100	3600										3600	Konfirmuar nga ASHK-ja	
15	Gezim	Xhevdet	Xhaballi	"	2783	229/61	Arë	1995	1995				30	100	3000										3000	Konfirmuar nga ASHK-ja	
Belorta																											
16	Adem	Sali	Benga	"	1145	199/179	Vreshta	342	342				36	100	3600										3600	Konfirmuar nga ASHK-ja	
17	Ismail	Scit	Xhaili	"	1145	121/38	Arë	264	264				36	100	3600										3600	Konfirmuar nga ASHK-ja	
18	Viktor	Malëq	Dakolli	"	1145	142	Arë	2322	2322				72	100	7200										7200	Konfirmuar nga ASHK-ja	
19	Ekuran	Zenel	Skotoli	"	1145	130/92	Arë	920	920				30	100	3000										3000	Konfirmuar nga ASHK-ja	
Bashkia Korçë A.S.H.K. Korçë																											
Kuç i Zi																											
20	Asllan	Shenif	Hoxha	"	2307	102/4	Truall Arë	1550	1550			5	141	49	100	4900									4900	Konfirmuar nga ASHK-ja	
21	Agim	Qerim	Osmanllari	"	2307	89/45	Arë	1380	1380			7	250	30	100	3000									3000	Konfirmuar nga ASHK-ja	
22	Henë Blerta Ertanuela Admir	Resul Kurtali Kurtali Kurtali	Liço Liço Liço Liço	"	2307	91/93/8	Arë	600	600				36	100	3600										3600	Konfirmuar nga ASHK-ja	
Plasë																											
23	Maksut Almir	Sali Maksut	Isufi Sali	"	2984	211/32	Vreshta	400	400				30	170	5100										5100	Konfirmuar nga ASHK-ja	
Zemblak																											
24	Skender	Asllan	Kulla	"	3903	143/13	Arë	1177	1177				36	100	3600										3600	Konfirmuar nga ASHK-ja	
25	Almir	Minir	Bregolli	"	3903	153/3	Arë	876	876				72	100	7200										7200	Konfirmuar nga ASHK-ja	
26	Minir	Nevrus	Bregu	"	3903	314/11	Arë	1420	1420				30	100	3000										3000	Konfirmuar nga ASHK-ja	
Bashkia Devoll A.S.H.K. Devoll																											
Çangonj																											
27	Idahet	Shaban	Bajraktari	"	1355	118/2	Arë	1200	1200				36	225	8100										8100	Konfirmuar nga ASHK-ja	
28	Mustafa	Sami	Shchu	"	1355	104/3	Arë +Truall	1280	930	350	91		30	225	6750										6750	Konfirmuar nga ASHK-ja	
29	Fuat	Haki	Mati	"	1355	56/16	Arë	538	538				30	225	6750										6750	Konfirmuar nga ASHK-ja	
30	Azem	Fan	Çibuku	"	1355	56/2	Arë	3101	3101				30	225	6750										6750	Konfirmuar nga ASHK-ja	
Vranisht																											
31	Subi	Mustafa	Taho	"	3822	195/17	Arë	3600	3600				30	168	5040										5040	Konfirmuar nga ASHK-ja	



32	Arti	Ythi	Koroli	"	3822	208/314	Arë	600	600							30	168	5040									5040	Konfirmuar nga ASHK-ja																					
33	Hasan	Ismail	Stegu	"	3822	249/5	Arë	6800	6800							30	168	5040									5040	Konfirmuar nga ASHK-ja																					
34	Dashi	Shyqyr	Hoxha	"	3822	258/20	Arë	2910	2910							49	168	8232									8232	Konfirmuar nga ASHK-ja																					
35	Fatmir	Sabri	Zizoli	"	3822	258/5	Arë	2600	2600							36	168	6048									6048	Konfirmuar nga ASHK-ja																					
Pilor																																																	
36	Setar	Bexhet	Kaprelli	"	2959	258/20	Arë	3459	3459							36	168	6048									6048	Konfirmuar nga ASHK-ja																					
37	Fatmir	Hysen	Spaho	"	2959	340/10	Arë	2008	2008							30	168	5040									5040	Konfirmuar nga ASHK-ja																					
Bashkia Devoll ASHK Devoll																																																	
Eçmenik																																																	
38	Sotir	Nuri	Dragoj	"	1588	25/7	Arë	3435	3435							30	168	5040									5040	Konfirmuar nga ASHK-ja																					
39	Dervish	Selman	Malo	"	1588	24/43	Arë	2697	2697							49	168	8232									8232	Konfirmuar nga ASHK-ja																					
Bimëkë																																																	
40	Simo	Hysen	Bregu	"	1202	469/26	Arë	5000	5000							30	225	6750									6750	Konfirmuar nga ASHK-ja																					
41	Skënder	Abidin	Xhafi	"	1202	464/5	Arë	4000	4000							30	225	6750									6750	Konfirmuar nga ASHK-ja																					
42	Astrit	Haxhi	Kodra	"	1202	478/6	Arë	3824	3824							30	225	6750									6750	Konfirmuar nga ASHK-ja																					
43	Barjam	Suleman	Topalli	"	1202	480/3	Arë	5800	5800							30	225	6750									6750	Konfirmuar nga ASHK-ja																					
44	Djana Restina Xhoana Fardis	Ali Gëzim Gëzim Hysi	Hysi Hysi Hysi	"	1202	481/3	Arë	6232	6232							30	225	6750									6750	Konfirmuar nga ASHK-ja																					
45	Hythi	Suleman	Sllogu	"	1202	766/3	Arë	6206	6206							30	225	6750									6750	Konfirmuar nga ASHK-ja																					
46	Elisa Enakli Redina	Ismail Ismail Ismail	Mersuli Mersuli Mersuli	"	1202	767/6	Arë	7144	7144							30	225	6750									6750	Konfirmuar nga ASHK-ja																					
47	Urim Fajbolla	Remzi Remzi	Xhemo Tagelli	"	1202	769/3	Arë	6300	6300							30	225	6750									6750	Konfirmuar nga ASHK-ja																					
48	Sami	Sali	Xhemo	"	1202	770/2	Arë	4204	4204							30	225	6750									6750	Konfirmuar nga ASHK-ja																					
49	Avni	Reshat	Hysi	"	1202	771/2	Arë	3600	3600							30	225	6750									6750	Konfirmuar nga ASHK-ja																					
50	Ali	Ibrahim	Bujku	"	1202	773/2	Arë	5643	5643							30	225	6750									6750	Konfirmuar nga ASHK-ja																					
51	Erjon Arben Dritan	Remzi Tefik Dashmir	Revani Qorllari Bode	"	1202	792/67	T'nuall	1120	1120							56	357	19992									19992	Konfirmuar nga ASHK-ja																					
SHUMA																	281,972											418,313											700,285										



VENDIM
Nr. 159, datë 17.2023

PËR MIRATIMIN E FORMËS E TË
PËRMBAJTJES SË DOKUMENTIT TË
UDHËTIMIT PËR TË HUAJT PA
SHTETËSI, TË DOKUMENTIT TË
UDHËTIMIT, LEJES SË KALIMIT, TË
DOKUMENTIT TË PËRKOZHSHËM,
DUBLIKATËS SË LEJES SË QËNDRIMIT
E TË LEJES UNIKE, SI DHE TË
LETËRNJOFTIMIT PËR TË HUAJT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 12, pika 7, 13, pika 3, 15, pika 2, 38, pika 2, e 96, pika 3, të ligjit nr. 79/2021, “Për të huajt”, me propozimin e ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e formës e të përmbajtjes së dokumentit të udhëtimit për të huajt pa shtetësi sipas aneksit nr. 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Miratimin e formës e të përmbajtjes së dokumentit të udhëtimit për shtetasit e huaj sipas aneksit nr. 2, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

3. Miratimin e formës e të përmbajtjes së lejes së kalimit për të huajt sipas modelit të përcaktuar në aneksin nr. 3, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

4. Miratimin e formës e të përmbajtjes së dokumentit të përkohshëm pas humbjes ose dëmtimit të dokumentit të udhëtimit, lejes së kalimit, lejes së qëndrimit dhe letërnjoftimit për të huajt, lëshuar nga autoriteti përgjegjës vendor për kufirin dhe migracionin, sipas formatit të përcaktuar në aneksin nr. 4, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

5. Miratimin e formës e të përmbajtjes së dublikatës së lejes së qëndrimit dhe lejes unike për të huajt, sipas aneksit nr. 5, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

6. Miratimin e formës e të përmbajtjes së letërnjoftimit për të huajt sipas modelit të përcaktuar në aneksin nr. 6, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

7. Vendimi nr. 442, datë 15.6.2016, i Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e formës dhe të përmbajtjes së dokumentit të udhëtimit për personat pa shtetësi dhe lejes së kalimit për të huajt”, shfuqizohet.

8. Ngarkohen Ministria e Brendshme dhe Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

ANEKSI NR. 1
FORMA DHE PËRMBAJTJA E
DOKUMENTIT TË UDHËTIMIT

“PASAPORTË PËR TË HUAJT PA
SHTETËSI”

- Dokumenti i udhëtimit “pasaportë për të huajt pa shtetësi” është me përmasa 125x88 mm, me qoshe të rrumbullakëta dhe ka 50 faqe (përfshijto kapakët).

- Kapaku i dokumentit të udhëtimit për të huajt pa shtetësi është në ngjyrën blu.

- Në faqen ballore të kapakut të dokumentit, në pjesën e sipërme të saj shkruhet në gjuhën shqipe dhe anglisht “REPUBLIKA E SHQIPËRISË / REPUBLIC OF ALBANIA”.

- Në faqen ballore të kapakut të dokumentit, në pjesën e mesit vendoset emblema e Republikës së Shqipërisë.

- Në faqen ballore të kapakut, në pjesën e poshtme dhe në faqen e parë të fletës së personalizuar shkruhet në gjuhën shqipe dhe angleze: “DOKUMENT UDHËTIMI PËR TË HUAJT PA SHTETËSI (Konventa 28 shtator 1954) / TRAVEL DOCUMENT (Convention of 28 September, 1954)”.

- Në faqen e përparme të të dhënave shkruhet në gjuhën shqipe dhe angleze: “REPUBLIKA E SHQIPËRISË / REPUBLIC OF ALBANIA”; në mes të saj shkruhet në gjuhën shqipe dhe angleze: “DOKUMENT UDHËTIMI (Konventa e shtator 1954) / TRAVEL DOCUMENT (28 September 1954 Convention)”; në pjesën e poshtme të saj shkruhet në gjuhën shqipe dhe angleze: “KY DOKUMENT PËRMBAN 50 FAQE/ THIS DOCUMENT CONTAINS 50 PAGES.



- Në faqen e të dhënave mbi fotografinë e aplikuesit shkruhet në ngjyrë të bardhë dhe sfond blu, në gjuhën shqipe dhe angleze: “DOKUMENT UDHËTIMI/TRAVEL DOCUMENT”.

- Në faqen e të dhënave tipi i dokumentit do të jetë ‘PT’. Autoriteti lëshues është MB (Ministria e Brendshme) dhe fillimi i zonës së lexueshme nga makina (MRZ) fillon me ‘PT’ në vend të ‘P’ që vendoset në pasaportat normale shqiptare.

- Kodi 3-shifror zëvendësohet me kodin kombëtar të transmetuar nga RKGJC-ja për të huajt pa shtetësi.

Shënim.

- Specifikimet teknike dhe elementet e sigurisë së dokumentit të udhëtimit për të huajt janë të njëjta me ato të dokumentit për refugjatët dhe shtetasit shqiptarë.

ANEKSI NR.2

FORMA DHE PËRMBAJTJA E DOKUMENTIT TË UDHËTIMIT

“PASAPORTË PËR SHTETASIT E HUAJT”

- Dokumenti i udhëtimit “pasaportë për të huajt” është me përmasa 125x88 mm, me qoshe të rrumbullakëta dhe ka 50 faqe (përfshijë kapakët).

- Kapaku i dokumentit të udhëtimit për të huajt është në ngjyrën blu.

- Në faqen ballore të kapakut të dokumentit, në pjesën e sipërme të saj shkruhet në gjuhën shqipe dhe anglisht “REPUBLIKA E SHQIPËRISË / REPUBLIC OF ALBANIA”.

- Në faqen ballore të kapakut të dokumentit, në pjesën e mesit vendoset emblema e Republikës së Shqipërisë.

- Në faqen ballore të kapakut, në pjesën e poshtme dhe në faqen e pare të fletës së personalizuar shkruhet në gjuhën shqipe dhe angleze: “DOKUMENT UDHËTIMI PËR TË HUAJT / TRAVEL DOCUMENT FOR FOREIGNERS”.

- Në faqen e përparme të të dhënave shkruhet në gjuhën shqipe dhe angleze: “REPUBLIKA E SHQIPËRISË / REPUBLIC OF ALBANIA”; në mes të saj shkruhet në gjuhën shqipe dhe angleze: “DOKUMENT UDHËTIMI PËR TË HUAJT/ TRAVEL DOCUMENT FOR FOREIGNERS në pjesën e poshtme të saj shkruhet në gjuhën shqipe dhe angleze: “KY DOKUMENT PËRMBAN 50 FAQE/ THIS DOCUMENT CONTAINS 50 PAGES”.

- Në faqen e të dhënave mbi fotografinë e aplikuesit shkruhet në ngjyrë të bardhë dhe sfond blu, në gjuhën shqipe dhe angleze: “DOKUMENT UDHËTIMI/TRAVEL DOCUMENT”.

- Në faqen e të dhënave tipi i dokumentit do të jetë ‘PT’. Autoriteti lëshues është MB (Ministria e Brendshme) dhe fillimi i zonës së lexueshme nga makina (MRZ) fillon me ‘PT’ në vend të ‘P’ që vendoset në pasaportat normale shqiptare.

- Kodi 3-shifror zëvendësohet me kodin kombëtar të transmetuar nga RKGJC-ja për të huajt.

ANEKSI NR. 3

FORMA DHE PËRMBAJTJA E DOKUMENTIT

“LEJE KALIMI PËR TË HUAJT”

- Leja e kalimit për të huajt është letër në përmasat 210X297 (format A4)

- Peshë specifike e letres që përdoret për leje kalimi është 100-120 gr/m²

- Dokumenti “Leje kalimi për të huajt” përmban këto elemente sigurie:

- Shtyp me bojë të padukshme (të dukshme vetëm nën veprimin e dritës UV);

- Numri i serisë 7-shifror me bojë fluoreshente.

- Leja e kalimit për të huajt ka përmbajtjen si formati në vijim.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
REPUBLIC OF ALBANIALEJE KALIMI PËR TË HUAJT
VETËM PËR NJË UDHËTIMLaissez Passer FOR FOREIGNERS
FOR A SINGLE JOURNEY ONLY

No. XXXXXXXX

Autoriteti lëshues _____
Issuing authorityMbiemri _____
Family nameEmri(at) _____
Given NamesShtetësia e Mbajtësit _____
Citizenship of bearerDatëlindja _____
Date of BirthGjinia _____ Vendlindja _____
Sex Place of BirthFotografia
Photograph

Nënshkrimi i mbajtësit / Signature of bearer

Ky dokumenti është i vlefshëm vetëm për një udhëtim nga: _____

në: _____
This document is valid for a single journey only as from: (Shtetit /State) to
(Shtetit /State)

Rezervuar për VIZE / Reserved for VISA

Lëshuar në _____, (Vendi), më _____ (Data)

Issued at _____, (Place), on _____ (Date)

E vlefshme deri më _____ (Data)

Valid until _____ (Date)



SHËNIME / OBSERVATIONS

Nënshkrimi i Nëpunësit Lëshues
Signature of issuing OfficerKy dokument është pronë e Shtetit Shqiptar
Autoritetet aeroportuale të vendeve transite janë të lutur
të asistojnë personin e interesuar gjatë procedurave të
kalimit transitit, nëse është e nevojshme.This document is property of Albanian State
The transit airport authorities are pleased to assist, if
necessary, the interested person during the transit
procedures.



ANEKSI Nr. 4

FORMA DHE PËRMBAJTJA E DOKUMENTIT TË PËRKOHSHËM PËR SHTETASIT E HUAJ

ANEKSI Nr. 4

FORMA DHE PËRMBAJTJA E DOKUMENTIT TË PËRKOHSHËM PËR TË HUAJT

- Dokumenti i përkohshëm për të huajt është letër në përmasat 210x297 (format A4);
- Dokumenti i përkohshëm për të huajt ka përmbajtjen si në vijim:



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E BRENDSHME
 DREJTORIA E PËRGJITHSHME E POLICISË SË SHTETIT
 DEPARTAMENTI PËR KUFIRIN DHE MIGRACIONIN
 Drejtoria Vendore për Kufirin dhe Migracionin _____

DOKUMENT I PËRKOHSHËM
Temporary document

PËR ZËVENDËSIMIN E: Dokumentit të udhëtimit për të huajt
For the replacement of *Travel document for foreigners*

Lejes së kalimit për të huajt
Laissez passer for foreigners

Letërnjoftimit për të huajt
Identification card for foreigners

Lejes së qëndrimit për të huajt
Residence permit for foreigners

☐

☐

☐

☐

TE DHENAT E PERSONIT:
Personal data

EMRI (AT), MBIEMRI _____
First name (s), Family name

VENDLINDJA _____ DATËLINDJA dd.mm.yyyy
Place of birth Date of birth

NUMRI IDENTITETIT PËR TË HUAJT (FID) _____
Foreigner Identity Number FID

SHTETËSIA _____ GJINIA _____ GJENJA CIVILE _____
Nationality Sex Civil Status

TË DHËNAT E DOKUMENTIT TË HUMBUR/DËMTUAR:
 Nr. Dokumentit _____, Data e lëshimit _____, Data e skadimit _____
No. of Document Date of issue Expire date

Autoriteti lëshues _____
Issuing authority

Ky dokument është i vlefshëm nga data _____ deri më datë _____
This document is valid from date until date

Foto
Photograph

DREJTORI
 DIRECTOR
 Nënshkrimi, Vula e Autoritetit
Signature, Stamp of Authority



ANEKSI NR. 5

FORMA DHE PËRMBAJTJA E DOKUMENTIT DUBLIKATË LEJE QËNDRIMI PËR TË HUAJT DHE DUBLIKATË LEJE UNIKE PËR TË HUAJT

- Dokumenti dublikatë leje qëndrimi / leje unike për të huajt është letër në përmasat 210x297 (format A4);
- Dokumenti i përkohshëm për shtetasit të huajt ka përmbajtjen si në vijim:

Nr. _____			
REPUBLIKA E SHQIPËRISË MINISTRIA E BRENDSHME DREJTORIA E PËRGJITHSHME E POLICISË SË SHETIT DEPARTAMENTI PER KUFIRIN DHE MIGRACIONIN Drejtoria Vendore për Kufirin dhe Migracionin _____			
DUBLIKATE LEJE QËNDRIMI PËR TË HUAJT DUBLICATE RESIDENCE PERMIT OF FOREIGNERS			
TIPI <i>Type</i> _____			
EMRI (AT), MBIEMRI _____ <i>First name (s), Family name</i>		Foto <i>Photograph</i>	
VENDLINDJA _____ <i>Place of birth</i>	DATËLINDJA dd.mm.yyyy <i>Date of birth</i>		
NUMRI IDENTITETIT PER TE HUAJT (FID) _____ <i>Foreigner Identity Number FID</i>			
SHETËSIA _____ <i>Nationality</i>	GJINIA _____ <i>Sex</i>	GJENJA CIVILE _____ <i>Civil Status</i>	
MOTIVI I QËNDRIMIT _____ <i>Purpose of Stay</i>			
ADRESA NË SHQIPËRI _____ <i>Address in Albania</i>			
Kjo dublikatë leje qëndrimi është e vlefshme nga data dd.mm.yyyy, deri më datë dd.mm.yyyy <i>This Duplicate of Residence Permit is valid from dd.mm.yyyy, until dd.mm.yyyy</i>			
DREJTORI DIRECTOR _____ Nënshkrimi, Vula e Autoritetit <i>Signature, Stamp of Authority</i>			



Nr. _____



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E BRENDSHME
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E POLICISË SË SHTETIT
DEPARTAMENTI PER KUFIRIN DHE MIGRACIONIN
Drejtoria Vendore për Kufirin dhe Migracionin _____

DUBLIKATË LEJE UNIKE PËR TË HUAJT
DUPLICATE SINGLE PERMIT OF FOREIGNERS

TIPI _____
Type

Foto
Photograph

EMRI (AT), MBIEMRI _____
First name (s), Family name

VENDLINDJA _____ DATËLINDJA dd.mm.yyyy
Place of birth Date of birth

NUMRI IDENTITETIT PER TE HUAJT (FID) _____
Foreigner Identity Number FID

SHTETËSIA _____ GJINIA _____ GJENJA CIVILE
Nationality Sex Civil Status

MOTIVI I QËNDRIMIT _____
Purpose of Stay

ADRESA NË SHQIPËRI _____
Address in Albania

Kjo dublikatë leje unike është e vlefshme nga data dd.mm.yyyy deri më datë dd.mm.yyyy
This Duplicate of Single Permit is valid from dd.mm.yyyy until dd.mm.yyyy

DREJTORI
DIRECTOR
Nënshkrimi, Vula e Autoritetit
Signature, Stamp of Authority



ANEKSI nr.6
FORMA DHE PËRMBAJTJA E
DOKUMENTIT LETËRNJOFTIM PËR TË
HUAJT

I. TRUPI I LETËRNJOFTIMIT PËR TË
HUAJT

Letërnjoftimi për të huajt në formatin D1 përbëhet nga shtresa të ndryshme prej materiali *polycarbonat*. Procesi i laminimit e bën trupin e kartës njësh e të pandashëm.

Dimensionet e letërnjoftimit për të huajt janë në përputhje me specifikimet teknike të standardit ISO 7810, me dimensionet, si vijon:

- **Gjerësi:**

min. 85.47 mm;

max. 85.72 mm;

- **Lartësi:**

min. 53.93 mm;

max. 54.04 mm;

- **Të katër qoshet të harkuara me reze:**

$r = 2.88$;

$r = 3.48$ mm (ISO 7813).

II. PËRMBAJTJA E LETËRNJOFTIMIT
PËR TË HUAJT

Trupi i letërnjoftimit për të huajt është i përbërë nga material *polycarbonat* dhe pamja e dy faqeve është si në fig. 1 dhe fig. 2.

Të gjitha të dhënat printohen me teknologji “*laser engraving*”.

Informacioni - Titulli i dokumentit në shqip dhe në anglisht:

LETËRNJOFTIM PËR TË HUAJT

Fig. 1: Faqja e përparme

LETËRNJOFTIM PËR TË HUAJT	
REPUBLIKA E SHQIPËRISË /	
REPUBLIC OF ALBANIA	
The identity document for foreigners	
Foto	Mbiemri/ surname Emri / given name Vendlindja / place of birth Ditëlindja / date of birth Gjinia Data e lëshimit Data e skadimit Autoriteti lëshues Nr. personal Nr. i letërnjoftimit
Firma / signature	

Fig. 2: Faqja e prapme

Motivi i qëndrimit / Purpose of Stay
Adresa / address

UDHËZIM

Nr. 1, datë 17.3.2023

**PËR MIRATIMIN E METODOLOGJISË
PËR LLOGARITJEN E ÇMIMIT
MESATAR TË SHITJES SË BANESAVE
NË TREG**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 10, të nenit 2, të ligjit nr. 22/2018, “Për strehimin social”, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

UDHËZON:

1. Qëllimi i këtij udhëzimi është miratimi i metodologjisë që shërben për llogaritjen e çmimeve mesatare të shitblerjes së banesave në treg, me qëllim përdorimin e tyre nga Enti Kombëtar i Banesave (EKB) ose njësitë e vetëqeverisjes vendore:

a) për të vlerësuar, nëse në territorin e një njësie të vetëqeverisjes vendore është më ekonomike të ndërtohen banesa të reja apo të blihen nga tregu;

b) për ta përdorur si nivel reference, në rastet kur vendosin të blejnë banesa në tregun e lirë;

c) për të përcaktuar kufirin maksimal të kreditimit, në zbatim të pikës 30, të vendimit nr. 453, datë 3.7.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për masën e subvencionit të interesave të kredisë dhe procedurën e dhënies së tij për familjet që përfitojnë banesë me kosto të ulët, me kredi të lehtësuara nga shteti”.

2. Për mbledhjen dhe përpunimin e të dhënave, sipas këtij udhëzimi, dhe për llogaritjen e çmimeve mesatare, sipas metodologjisë së përcaktuar në këtë udhëzim, brenda 10-ditëshit të parë të çdo katërmujori, duke filluar nga muaji tetor, Agjencia Shtetërore e Kadastrës (ASHK) i përcjell Drejtorisë së Përgjithshme të EKB-së të dhëna për të gjitha transaksionet e kryera nga regjistrimi i kontratave për titujt e pronësisë, sipas formatit të tabelës nr.1, të shtojcës “B”, që i bashkëlidhet këtij udhëzimi.

3. Kur ASHK-ja nuk disponon të dhëna për zona të caktuara kadastrale, EKB-ja i referohet të



dhënave të vitit parardhës për atë zonë dhe, nëse sërish nuk disponohen të dhëna për të paktën dy ose më shumë transaksione të kryera në atë zonë kadastrale, si referencë në zbatim të qëllimit të përcaktuar në pikën 1, të këtij udhëzimi, merret kostoja e ndërtimit të banesave në atë zonë.

4. Çmimet e shitblerjes në treg të lirë merren për transaksionet e kryera për banesa shumë familjare, në kuptim të vendimit nr.626, datë 15.7.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e normativave të projektimit të banesave”, të cilat:

a) janë të ndërtuara para viteve 1990 dhe pas viteve 1990;

b) ndodhen në zona dhe nënzona kadastrale;

c) janë me sipërfaqe të ndryshme, të ndara sipas strukturave: garsoniere/studio (G/S), mansard (M), 1+1, 2+1 dhe 3+1.

5. Llogaritja e çmimeve mesatare kryhet nga EKB-ja, brenda muajit nëntor, për çdo transaksion të kryer, sipas zonave kadastrale, të çmimit të shitjes për metër katror sipërfaqe banese dhe pasqyrohet, sipas formatit të tabelave nr. 2 dhe nr. 3, të shtojcës “B”, që i bashkëlidhet këtij udhëzimi. EKB-ja përcjell menjëherë pranë ministrisë përgjegjëse për strehimin tabelat e plotësuara.

6. Sipërfaqe banese, sipas pikës 5, të këtij udhëzimi, është sipërfaqja e njësisë së banimit të regjistruar në ASHK, në bazë të certifikatës së pronësisë, bazuar në vendimin nr. 782, datë 7.10.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e modeleve të akteve kadastrale dhe të dhënave në përmbajtje të hartës kadastrale”.

7. Mesatarja e çmimeve të tregut për çdo zonë kadastrale llogaritet si mesatare aritmetike e të gjitha çmimeve për metër katror. Në llogaritjen e çmimit mesatar përjashtohen nga llogaritja çmimet e grupit të dhjetë (decil) më të lartë, kur mesatarja e çmimeve të këtij grupi është më e lartë 1.3 herë sesa mesatarja e nëntë grupeve të tjera. Një shembull i llogaritjes së decilit më të lartë, sipas kësaj pike, pasqyrohet në shtojcën “A”, që i bashkëlidhet këtij udhëzimi.

8. Të dhënat sipas tabelave nr. 2 dhe 3, të shtojcës “B”, që i bashkëlidhet këtij udhëzimi, miratohen brenda muajit dhjetor të çdo viti nga ministri përgjegjës për strehimin dhe botohen në Fletoren Zyrtare.

9. Ngarkohen ministria përgjegjëse për strehimin, Enti Kombëtar i Banesave, Agjencia

Shtetërore e Kadastrës dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore për zbatimin e këtij udhëzimi.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

SHTOJCA A

Supozojmë se kemi mbledhur të dhënat mbi çmimin e banesave për 50 njësi banimi ($N = 50$).

Hapi 1: Të dhënat i hedhim në Excel në kolonën B të tabelës nr. 1.

Hapi 2: Rreshtojmë të dhënat e kolonës B nga numri më i vogël tek numri më i madh dhe shënojmë me 1, 2 ... 50 numrat rendorë në kolonën A.

Hapi 3: Llogarisim pozicionin e shifrës që i korrespondon decilit me çmimet më të larta me formulën:

$$K_{D9} = 9 \times (n + 1) / 10 = 9 \times (50 + 1) / 10 = 45.9$$

Rezulton që numri i decilit të nëntë gjendet midis shifrave në qelizat ‘B45’ dhe ‘B46’, konkretisht 0.9 pikë më lart se shifra në qelizën ‘45’. Numrit rendor ‘45’ i korrespondon çmimi 231,800 lekë/m² dhe numrit rendor ‘46’ shifra është 244,000 lekë/m².

Hapi 4: Gjejmë se cila vlerë i korrespondon renditjes 45.9. Për këtë, përdorim formulën:

$$D9 = B45 + 0.9 \times (B46 - B45)$$

$$D9 = 231,000 + 0.9 \times (244,000 - 231,000) = 242,780$$

Tabela nr. 1

	A	B	C
1	N	Lekë/m ²	
2	1	97,600	
3	2	101,260	
4	3	103,700	
5	4	106,140	
41	...	...	
42	41	211,060	
43	42	213,500	
44	43	219,600	
45	44	225,700	
46	45	231,800	
47	46	244,000	
48	47	366,000	
49	48	488,000	
50	49	488,000	
51	50	610,000	
52			



Vlerat e decilit të dhjetë janë të gjitha ato vlera mbi 242,780 lekë/m².

Hapi 5: Krahasimi i mesatares së decilit të fundit me mesataren e të gjitha shifrave të tjera:

1. Mesatarja aritmetike e decilit të fundit rezulton 439,200 lekë/m².

2. Mesatarja e shifrave të nëntë grupeve të tjera rezulton 168,224 lekë/m²

3. Raporti i mesatares së decilit të fundit me mesataren e nëntë grupeve të tjera është $439,200/168,224 = 2.6$

Në këtë rast, çmimet e decilit të fundit nuk përfshihen në llogaritjen e çmimit mesatar. Nëse mesatarja e decilit të fundit do të ishte më e vogël ose e barabartë me 218,691 lekë/m² vlerat e decilit të fundit do të përfshiheshin në llogaritje.

**Shtojca B****Tabela nr 1:** Informacioni mbi çmimin mesatar të shit-blerjes së banesave nga Agjencia Shtetërore e Kadastrës

Nr.	Qarku	Njësia e vetëqeverisjes vendore	Njësia administrative	Zona Kadastrale	Viti i ndërtimit		Tipi i banesës					Sipërfaqe banese (njësi banimi), sipas regjistrimit në ASHK	Çmimi (lekë)
					Para 1990	Pas 1990	M	G/S	1+1	2+1	3+1		

Tabela nr. 2: Çmimet mesatare të shit-blerjes së banesave në tregun e lirë, sipas zonave të njësive të vetëqeverisjes vendore.

Nr.	Njësia e vetëqeverisjes vendore	Çmimi mesatar (lekë/ m2 sipërfaqe banese)	Zona Kadastrale	Çmimi (lekë/ m2)
1			ZK 1	
			ZK 2	

Tabela nr. 3: Çmimet mesatare të shit-blerjes së banesave në tregun e lirë, sipas zonave të njësive administrative të njësive të vetëqeverisjes vendore.

Nr.	Njësia Administrative	Zona Kadastrale	Çmimi mesatar (lekë/ m2 sipërfaqe banese)
1			
2			

**URDHËR**

Nr. 134, datë 10.3.2023

**PËR MIRATIMIN E RREGULLORES
“MBI PIKAT E REFERENCËS PËR
VEPRIM PËR SUBSTANCAT
FARMAKOLOGJIKISHT AKTIVE TË
PALEJUARA TË PRANISHME NË
USHQIMET ME ORIGJINË SHTAZORE”¹**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës, dhe pikës 3, të nenit 81, të ligjit nr. 10 465, datë 29.9.2011, “Për Shërbimin Veterinar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Miratimin e rregullore për vendosjen e pikave të referencës për veprim për substancat farmakologjikisht aktive të palejuara të pranishme në ushqimet me origjinë shtazore, në kuadër të implementimit të Planit Kombëtar të Monitorimit të Mbetjeve.

2. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit, Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve, Autoriteti Kombëtar i Ushqimit dhe Instituti i Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BUJQËSISË DHE
ZHVILLIMIT RURAL

Frida Krifca

RREGULLORE**MBI PIKAT E REFERENCËS PËR
VEPRIM PËR SUBSTANCAT
FARMAKOLOGJIKISHT AKTIVE TË
PALEJUARA TË PRANISHME NË
USHQIMET ME ORIGJINË SHTAZORE**

Neni 1

Fusha e zbatimit

Kjo rregullore përcakton:

a) rregullat për vendosjen e pikave të referencës për veprim për mbetjet e substancave farmakologjikisht aktive, për të cilat nuk është përcaktuar kufiri maksimal i mbetjeve, në përputhje me urdhrin nr. 363, datë 3.1.2013, “Për miratimin e rregullore ‘Mbi procedurat për vendosjen e kufijve të mbetjeve të lëndëve aktive farmakologjike në ushqimet me origjinë shtazore’”;

b) parimet metodologjike dhe metodat shkencore për vlerësimin e riskut të sigurisë së pikave të referencës për veprim;

c) pikat e referencës për veprim për mbetjet nga substanca të caktuara farmakologjike aktive, për të cilat nuk ka kufi maksimal të mbetjeve, sipas përcaktimeve në urdhrin nr. 363, datë 3.1.2013, “Për miratimin e rregullore ‘Mbi procedurat për vendosjen e kufijve të mbetjeve të lëndëve aktive farmakologjike në ushqimet me origjinë shtazore’”.

d) rregullat specifike për veprimet që ndërmerren në rastin e pranisë së mbetjes së konfirmuar të një substance të ndaluar ose të palejuar në nivele më të larta, të barabarta ose nën pikën e referencës për veprim.

Neni 2

**Rregullat për vendosjen e pikave të
referencës për veprim**

Pikat e referencës për veprim vendosen në nivelin më të ulët që mund të arrihen në mënyrë analitike nga laboratorët zyrtarë të kontrollit pranë Institutit të Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë (ISUV). Pikat e referencës për veprim rishikohen rregullisht për të siguruar që ato korrespondojnë me nivelet më të ulëta, të cilat janë të arritshme, duke marrë parasysh zhvillimet më të fundit shkencore.

¹ Rregullore e Komisionit (BE) 2019/1871, e datës 7 nëntor 2019, “Mbi pikat e referencës për veprim për substancat farmakologjike aktive të palejuara të pranishme në ushqimet me origjinë shtazore dhe shfuqizimin e vendimit 2005/34/EC”.



Neni 3

Parimet metodologjike dhe metodat shkencore të vlerësimit të riskut

1. Vlerësimi i riskut i aplikuar për vlerësimin e sigurisë së pikave të referencës për veprim merr parasysh:

a) potencialin toksik dhe aktivitetin farmakologjik të substancës;

b) marrja e mbetjes nëpërmjet ushqimit.

2. Për përcaktimin e potencialit toksik dhe aktivitetit farmakologjik të substancës zbatohen vlerat e mëposhtme të ekzaminimit toksikologjik:

a) për substancat e grupit I, që korrespondojnë me substanca farmakologjikisht aktive të palejuara, për të cilat ka prova të drejtpërdrejta të gjenotoksicitetit ose për të cilat ka një alarm për gjenotoksicitet ose për të cilat ka mungesë informacioni mbi gjenotoksicitetin: 0,0025 µg/kg peshë trupore (b.w.) në ditë;

b) për substancat e grupit II, që korrespondojnë me substancat farmakologjikisht aktive të palejuara me aktivitet farmakologjik mbi sistemin nervor ose sistemin riprodhues, ose që janë kortikoidë 0,0042 µg/kg peshë trupore (b.w.) në ditë;

c) për substancat e grupit III, që korrespondojnë me substanca farmakologjikisht aktive të palejuara me efekt antiinfektiv, antiinflamator dhe antiparazitar dhe agjentë të tjerë farmakologjik aktivë 0,22 µg/kg peshë trupore (b.w.) në ditë.

3. Marrja përkatëse e ushqimit përcaktohet bazuar në shifrat e konsumit të ushqimit, modelet e konsumit të ushqimit dhe praninë e substancës në produkte të ndryshme ushqimore.

4. Siguria e pikave të referencës për veprim vlerësohet, duke verifikuar nëse vlera e ekzaminimit toksikologjik, e ndarë me marrjen e ushqimit përkatës, është më e lartë ose e barabartë me aftësinë analitike të laboratorëve zyrtarë të kontrollit, në këtë rast, siguria e pikës së referimit për veprim në nivelin e aftësisë analitike është e garantuar.

Neni 4

Zbatimi i pikave të referencës për veprim

Për qëllimin e kontrollit në ushqimin me origjinë shtazore të disa mbetjeve të substancave, përdorimi i të cilave është i ndaluar ose i palejuar, pikat e referencës për veprim, të përcaktuara në

aneksin I, do të zbatohen pavarësisht nga matrica e ushqimit të testuar.

Ushqimi me origjinë shtazore, që përmban mbetje të një substance farmakologjikisht aktive në një përqendrim në ose mbi pikën e referencës për veprim, konsiderohet jo në përputhje me legjislacionin kombëtar dhe nuk hynë në zinxhirin ushqimor.

Ushqimi me origjinë shtazore, që përmban mbetje të një lënde farmakologjikisht aktive në një përqendrim nën pikën e referencës për veprim nuk ndalohet të hyjë në zinxhirin ushqimor.

Neni 5

Shkëmbimi i informacionit dhe hetimet në rast të pranisë së konfirmuar të një substance të ndaluar ose të palejuar

Kur rezultatet e kontroleve zyrtare, duke përfshirë testet analitike, identifikojnë mbetjet e substancave të ndaluara ose të palejuara në nivele mbi, të barabarta ose nën pikat e referencës për veprim, Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve (AKVMB) kryejnë hetimet, për të përcaktuar nëse ka pasur trajtim të paligjshëm me një substancë farmakologjike aktive të ndaluar ose të palejuar.

Në rast të mospërputhshmërisë së konstatuar, AKVMB-ja, për kryerjen e kontroleve zyrtare, ndërmerr një ose më shumë veprime, sipas kërkesave të legjislacionit kombëtar për kryerjen e kontroleve zyrtare, si edhe mban një regjistër të gjetjeve.

ISUV-ja, në rastin e rezultateve të analizave jo në përputhje me normat e vendosura në legjislacionin në fuqi, që tregojnë praninë e konfirmuar të një substance të ndaluar ose të palejuar në nivele mbi ose të barabarta me pikat e referencës për veprim njofton menjëherë Drejtorinë e Politikave Veterinare, AKVMB-në dhe Autoritetin Kombëtar të Ushqimit (AKU).

Për produktet me origjinë shtazore, me synim eksportin/importin, struktura përgjegjëse për sistemin e informimit të shpejtë për ushqimin dhe ushqimin për kafshë, njofton Komisionin mbi rezultatet e kontroleve zyrtare, duke përfshirë testet analitike, që tregojnë praninë e konfirmuar të një substance të ndaluar ose të palejuar në nivele mbi ose të barabarta me pikat e referencës për veprim.



ANEKSI I

PIKAT E REFERENCËS PËR VEPRIM (RPA)

Substanca	RPA (µg/kg)	
Kloramfenikoli	0,15	
Malakiti jeshil	0,5	0,5 µg/kg për shumën e malakit jeshil dhe leucomalakitit jeshil
Nitrofurantet dhe metabolitët e tyre	0,5 ¹	0,5 µg/kg për secilin nga metabolitët e furazolidonit (AOZ ose 3-amino-2-oksazolidinon), furaltadonit (AMOZ ose 3-amino-5-metilmorfolino-2-oksazolidinonit), nitrofurantoinës (AHD ose 1-aminohidantoinës), nitrofurazone (SEM ose semikarbazid) dhe nifursol (DNSH ose 3,5-dinitrosalicylic acidhydrazide)

1. Për shkak të shfaqjes natyrore të SEM-së në *crayfish*/karavidhe në nivele mbi RPA-në, vetëm nivelet e AOZ-së, AMOZ-së, AHD-së dhe DNSH-së mbi RPA-në janë një tregues të qartë të përdorimit të paligjshëm të nitrofuraneve dhe metabolitëve të tyre. RPA-ja prej 0,5 µg/kg për SEM në *crayfish*/karavidhe do të zbatohet vetëm kur është vërtetuar përdorimi i paligjshëm i nitrofurazoneve në *crayfish*/karavidhe.

ANEKSI II

UDHËZUESI EURL MBI KËRKESAT MINIMALE TË PERFORMANCËS SË METODAVE (MMPR) PËR SUBSTANCAT SPECIFIKE FARMAKOLOGJIKE AKTIVE NË MATRICAT SPECIFIKE TË KAFSHËVE²

Qëllimi i këtij udhëzuesi teknik është të përmirësojë dhe harmonizojë performancën e metodave analitike të përdorura për analizën e mbetjeve të substancave farmakologjike aktive të paautorizuara ose të ndaluar dhe për substancat e autorizuar farmakologjike aktive, në matrica për të cilat nuk lejohet përdorimi, duke marrë parasysh metodat analitike moderne. Ky udhëzim shërben për Planin Kombëtar të Monitorimit të Mbetjeve, në përputhje me nenin 81 të ligjit nr. 10 465, datë 29.9.2011, “Për Shërbimin Veterinar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar dhe me të gjitha kontrollat e tjera zyrtare të kryera mbi mbetjet e substancave farmakologjike aktive në kafshët e gjalla që prodhojnë ushqim, pjesët e trupit dhe lëngjet e tyre, ekskrecionet, indet, produktet me origjinë shtazore, nënproduktet e kafshëve, ushqimi i kafshëve dhe uji.

Ushqimet me origjinë shtazore, që përmbajnë mbetje të një substance farmakologjike aktive në një përqendrim në ose mbi pikën e referencës për veprim, do të konsiderohet se nuk janë në përputhje me legjislacionin kombëtar dhe nuk do të

hyjnë në zinxhirin ushqimor.

Gjithashtu, pikat e referencës për veprim përcaktojnë kërkesat minimale të performancës së metodës (MMPR) për këto substanca në ushqim. Megjithatë, kur laboratorët janë në gjendje të identifikojnë me besueshmëri këto substanca në përqendrimet më të ulëta, këto përqendrimet çojnë në hetime për të verifikuar nëse ka ndodhur një trajtim i paligjshëm. Për substancat për të cilat pikat e referencës për veprim janë vendosur në ushqim, kjo rregullore përcakton MMPR-të në matricat joushqimore.

Për substancat farmakologjike aktive të ndaluara ose të paautorizuara, për të cilat nuk është vendosur pika e referencës për veprim në ushqim, ky dokument specifikon MMPR-të për substanca specifike në matricat specifike ushqimore dhe joushqimore.

Laboratorët duhet të sigurojnë që CC_β për metodat e shqyrtimit ose CC_α për metodat konfirmuese të jenë më të ulëta se MMPR-të.

Duhet theksuar se ky dokument është një udhëzues teknik për metodat analitike në kontrollin e mbetjeve. MMPR-të, në asnjë mënyrë nuk duhet të konsiderohen si limit detyrues. Ato përfaqësojnë përqendrimet minimale që laboratorët zyrtarë janë në gjendje të identifikojnë me besueshmëri. Në rast se disa laboratorë identifikojnë përqendrimet më të ulëta, në përputhje me kërkesat e metodës të përcaktuara nga rregulloret përkatëse, autoriteti kompetent mund të zbatojnë, gjithashtu përqendrimet më të ulëta të mbetjeve të substancave farmakologjikisht aktive të ndaluara ose të paautorizuara.

² Përafruar me “EURL Guidance on Minimum Method Performance Requirements (MMPRs) for specific pharmacologically active substances in specific animal matrices”.



Për arsye praktike $\mu\text{g}/\text{kg}$ dhe $\mu\text{g}/\text{l}$ janë zëvendësuar me ppb në të gjitha tabelat.

Për asistencë të mëtejshme teknike se si të përmirësohen metodat analitike në mënyrë që të

arrihen përqendrimet e rekomanduara duhet konsultimi me EURL përgjegjëse për substancën

EURL emri dhe grupet e substancave	Adresa
ANSES EURL	
Substancat antibakteriale, duke përfshirë sulfonamidet dhe quinolones Ngjyruetit Carbadox dhe olaquinox Kloramfenikoli Dapsone Nitrofurant	ANSES - Laboratoire de Fougères La Haute Marche – Javené – BP 90203 F-35302 Fougères, France Phone: +33(0)2 99 17 27 47 Director: Dr. Eric Verdon email: eurl-vmpr-fougères@anses.fr eric.verdon@anses.fr http://eurl-veterinaryresidues.anses.fr
BVL-EURL	
Beta-agonists Nitroimidazoles Anthelmintics Anticoccidials Non-steroidal anti-inflammatory drugs (NSAIDs)	Bundesamt für Verbraucherschutz und Lebensmittelsicherheit Diedersdorfer Weg 1 12277 Berlin, Germany Phone: + 49(0)30 18445-8210 Fax: + 49(0)30 18445-8099 Director: Dr. Joachim Polzer email: eurlvetdrug@bvl.bund.de https://fis-vl.bvl.bund.de/share/page/
WFSR-EURL	
Stilbenet, derivatet e stilbenit dhe kriperat e tyre dhe esteret Agjentët antitiroide Steroidet Laktonet e acidit resorcilik (RALs) duke përfshirë zeranolin Sedativet Mykotoksina	Wageningen Food Safety Research (former RIKILT) P.O. Box 230 6700 AE Wageningen, The Netherlands Phone: + 31(0)317 480256 Fax: + 31(0)317 417717 Director: Dr. Saskia Sterk email: eurl.growthpromoters@wur.nl Saskia.sterk@wur.nl

1. A1 Stilbenes (EURL WFSR Wageningen)

Për qëllime të kontrollit, matricat e zgjedhura janë urina e ndjekur nga mëlçia.

Muskuli është përfshirë për kontrollin e importeve dhe për produktet e importuara të

akuakulturës, por nuk është matrica e zgjedhur për planet rutinë, pasi përqendrimet e mbetjeve janë shumë të ulëta në muskuj.

Substancat	Matricë	MMPR*
Dietilstilbestrol (DES) Dienestrol (DE) Hexestrol (HEX) Benzestrol (BENZ)	Urinë	0.5 ppb for DES 1 ppb for DE, HEX, BENZ
	Mëlçi	1 ppb (për të gjitha substancat)
	Mishi (përfshirë peshkun)	1 ppb (për të gjitha substancat)

*CC_B për metodat e shqyrtimit/ screening ose CC_A për metodat konfirmuese duhet të jenë më të ulëta se vlera e shprehur në këtë kolonë.



2. A2 Thyrostats (EURL WFSR Wageningen)

Për qëllime të kontrollit matricat e zgjedhura janë urina dhe gjëndra tiroide. Muskujt janë përfshirë për kontrollin e importeve dhe për produktet e importuara të akuakulturës, por nuk është matrica e zgjedhur për planet rutinë, pasi

përqendrimet e mbetjeve janë shumë të ulëta në muskuj.

Duhet të theksohet se përqendrime të ulëta të *Thiouracil* (maksimumi 30 ppb) janë zbuluar në kafshë të ushqyera me një dietë që përmban bimë të familjes krucifere.

Substancat	Matricë	MMPR*
Thiouracil Methylthiouracil Propylthiouracil Benzylthiouracil Mercaptobenzimidazol	Urina Tiroide	10 ppb për të gjitha ^{ac}

* CC_β për metodat e shqyrtimit ose CC_α për metodat konfirmuese duhet të jetë më e ulët se vlera e ^{ac}përqendrimit e ulëta të *Thiouracil* janë zbuluar në kafshët gjedhe të ushqyera me bimë kryqëzuese, megjithatë ka prova shkencore që tregojnë se nivelet mbi 30 ppb në urinë kanë një shans të ulët për t'u lidhur me origjinën natyrore, për shkak të këtij kontaminimi. Megjithatë, ka raste kur tejkalohet 30 ppb për *Thiouracil* dhe nuk mund të gjendet asnjë burim ekzogjen. Hulumtimi mbi diskriminimin është në vazhdim e sipër. Për strategjitë më të fundit konsultohuni me letrën reflektuese të EURL, shprehur në këtë kolonë.

3. Steroidet A3 (EURL WFSR Wageningen)

Për qëllime kontrolli, matricat e zgjedhura janë urina e ndjekur nga mëlçia.

Për 17β-oestradiolin, testosteronin dhe esteret e estrogjeneve, androgjenet dhe progestagenet, serumi dhe forgestagenet, si yndyra e veshkave MPA është matrica e zgjedhur, siç tregohet në tabelë. Matrica flokë/qime mund të përdoren kur kontrollohen esteret e estradiolit, testosteronit,

nortestosteronit, boldenonit dhe estereve të tjera steroide. Muskujt janë përfshirë për qëllime kontrolli të importeve dhe për produktet e akuakulturës.

Për steroidet A3, jo të gjitha steroidet përmenden me emër në këtë dokument udhëzues. Në përgjithësi 0.5 ppb për shënuesin/marker e steroidit në urinë është një MMPR e pranueshme.

Substancat	Metaboliti i mbetjes së shenjëstruar ^s	Matrica	MMPR*
Boldenone [#]	17β-boldenone glucuronide (gjedh i ri)	Urinë	1 ppb
		Mëlçi	2 ppb
		Muskul	1 ppb
	17α-boldenon (gjedh, dele, dhi, kalë)	Urinë	0.5 ppb
		Mëlçi	2 ppb
		Muskul	1 ppb si β-boldenon
17β-19-Nortestosteroni ^{##} (nandrolone)	17α-19- Nortestosterone ^{###} (epi-nandrolone)	Urinë	0.5 ppb
		Mëlçi	2 ppb
		Muskul	1 ppb
Ethinylestradiol		Urinë	0.5 ppb
		Mëlçi	2 ppb
		Muskul	1 ppb
17β-oestradiol	17β-oestradiol	Plasma/serum	0.1 ppb
		Muscle	1 ppb
17β-oestradiol ester		Flokë/qimet	20 ppb
		Plasma/serum	0.1 ppb
17β-testosterone	17β-testosterone	Serum	Mashkull < 6 muaj: 10 ppb
			Mashkull 6 - 18 muajsh: 30



			ppb
			Femra < 18 muajsh: 0,5 ppb
17β-testosterone ester		Flokë/qime	10 ppb
		Serum	0.1 ppb
Methyltestosterone Methylboldenone		Urinë	0.5 ppb
		Mëlçi	2 ppb
		Muskul	1 ppb
Chlorotestosterone	17α-clostebol Chlorandrostenedione (CLAD)	Urinë	0.5 ppb
		Mëlçi	2 ppb
		Muskul	1 ppb
17β-trenbolone	17α-trenbolone	Urinë	0.5 ppb
		Mëlçi	2 ppb
		Muskul	1 ppb
		Qime	10 ppb (ester)
Stanozolol	16β-hydroxystanozolol	Urinë	0.5 ppb
		Mëlçi	2 ppb
		Muskul	1 ppb
		Qimet (stanozolol)	10 ppb
Dexamethasone		Urinë	0.5 ppb
		Mëlçi, muskul	MRL kur ka trajtim i autorizuar
Megestrol	Megestrol(acetate)	Yndyra në veshka	5 ppb
		Muskul	1.0 ppb
Melengestrol	Melengestrol (acetate)	Yndyra në veshka	5 ppb
		Muskul	1.0 ppb
Chlormadinone	Chlormadinone (acetate)	Yndyra në veshka	2 ppb
		Muskul	1 ppb
Medroxy-progesterone	Medroxy-progesterone (acetate)	Yndyra në veshka	1 ppb
		Muskul	1.0 ppb

* CC β për metodat e shqyrtimit ose CC α për metodat konfirmuese duhet të jenë më të ulëta se vlera e shprehur në këtë kolonë.

[#] Boldenone siç përshkruhet në punimin e grupit të ekspertëve të vitit 2003, referencë: Prania dhe metabolizmi i steroidit anabolik boldenone në lloje të ndryshme të kafshëve (Një përmbledhje. Korrik 2004, Aditivët e ushqimit dhe kontaminantët 21(6) : 515-25.)

^{\$} Kafshët e derrit nuk metabolizohen në α -izomere. Për kafshët e derrit, steroidi i administruar është shënuesi.

^{##} 17 β -19-nortestosteroni gjendet natyrshëm te derrat dhe kuajt e pakastruar. Për strategjitë më të fundit konsultohuni me EURL letër reflektimi.

^{###} 17 α -19-nortestosteroni shfaqet natyrshëm te lopët shtatzëna dhe viçat e porsalindur. Për strategjitë më të fundit konsultohuni me EURL letër reflektimi, këtë kolonë.

4. Laktonet dhe derivatet e Acidit Resorcylic A4 (EURL WFSR Wageningen)

Për qëllimin e kontrollit matricat e zgjedhura janë urina e ndjekur nga mëlçia. Muskujt janë

përfshirë për qëllim të kontrollit të importeve dhe për produktet e importuara të akuakulturës.

Substanca	Metaboliti i mbetjes së shenjëstruar	Matrica	MMPR*
Zeranol**	Taleranol	Urinë	1 ppb
		Mëlçi	2 ppb
		Muskul	1 ppb
Zearalenone		Urinë	2 ppb



		Mëlçi	2 ppb
α -zearalenol		Urinë	2 ppb
		Mëlçi	2 ppb
β -zearalenol		Urinë	2 ppb
		Mëlçi	2 ppb

*CC β për metodat e shqyrtimit ose CC α për metodat konfirmuese duhet të jetë më e ulët se vlera e shprehur në këtë kolonë.

**Në rast se janë të pranishëm si zëranoli ashtu edhe zëaraleni, prania e zëranolit konsiderohet si rezultat i kontaminimit me mykotoksinë. Ekzaminimi mund të bëhet mbi zëranol dhe metabolitët e tij shënues taleranol. Kur një nga këto komponime zbulohet nevojitet një profil i plotë i laktonit të acidit resorcilik (RAL) për të vendosur mbi mospërputhshmërinë. Për strategjitë më të fundit konsultohuni me letrën e reflektimit të EURL.

5. Beta-agonistët A5 (EURL BVL Berlin)

Për qëllime kontrolli matricat e zgjedhura janë urina dhe mëlçia dhe veçanërisht retina, pasi këtu mund të gjenden përqendrime më të larta të mbetjeve për një periudhë më të gjatë kohore. Analiza e syve të plotë është zgjedhja e dytë në krahasim me retinën që është zgjedhja e parë. Flokët/qimet janë, gjithashtu, një matricë e

rekomandueshme, megjithatë rreziku i ndotjes së jashtme duhet të merret parasysh. Kur merrni flokë/qime gjithmonë rekomandohet të merret edhe mostra e urinës në të njëjtën kohë nga e njëjta kafshë. Muskujt janë përfshirë për qëllime kontrolli të importeve, por përqendrimet në muskuj janë më të ulëta se në matricat e përmendura më parë.

Substanca	Matrica	MMPR*
Clenbuterol: MRL (për gjedhin dhe ekuidae**: 0.1 µg/kg në muskuj 0.05 µg/kg në qumësht (vetëm gjedh) 0.5 µg/kg në mëlçi dhe veshka	Urinë Mëlçi Mushkëri Muskuj Veshkë Feçe Plazma Ujë i pijshëm	0.1 ppb
Brombuterol, Bromchlorbuterol Cimaterol Cimbuterol Clenpenterol Clenproperol Hidroksimetilklenbuterol Mabuterol Mapenterol Tulobuterol	Retina Flokët/qimet (Screening)	1 ppb
Carbuterol Clencyclohexerol Isoxsuprine Ractopamine Ritodrin Salbutamol Terbutaline Zilpaterol	Urinë Mëlçi Mushkëri Muskuj Veshkë Feçe Plazma Ujë i pijshëm Retina Flokët/qimet (Screening)	0.5 ppb 5 ppb
Fenoterol, Salmeterol	Urinë Mëlçi Mushkëri Muskuj Veshkë Feçe	1 ppb



	Plazma	
	Ujë i pijshëm	
	Retina	5 ppb
	Flokët/qimet (Screening)	
Të gjitha analitet	Ushqim për kafshë	50 ppb

* CCβ për metodat e shqyrtimit ose CCα për metodat konfirmuese dubet të jenë më të ulëta se vlera e shprehur në këtë kolonë.

** Sipas urdhrit nr. 357, datë 22.12.2011, “Për miratimin e rregullores Mbi kushtet e tregimit dhe të përdorimit në kafshë të disa lëndëve me veprim hormonal ose tireostatik dhe te Beta-Agonistëve” beta-agonistët mund të autorizohen për trajtime terapeutike shumë të jashtëzakonshme dhe kufizuese.

6. A6 (EURL ANSES Fougères, BVL Berlin dhe WFSR Wageningen)

Për nitroimidazolet matricat e zgjedhura janë vezët, plazma/serumi dhe retina, të ndjekura nga – në varësi të specieve – muskujt. Më pas, qumështi

mund të zgjidhet nëse është i përshtatshëm. Për produktet e akuakulturës, muskujt janë matrica përkatëse, për më tepër krustacet dhe vezët e peshkut.

Substanca	Metaboliti i mbetjes së shenjëstruar	Matrica	MMPR*
Nitroimidazoles: Ronidazol Dimetridazol Metronidazol + 5 të tjera - nitroimidazolet	Hydroxy-metabolites	Shpendët: Plazma, serum, retina**, vezë Derra (dhe specie të tjera): Plazma, serum, muskuj, retina** Produktet e akuakulturës: Muskuj, Qumësht (Ujë i pijshëm)	1 ppb
		Ushqim për kafshë	50 ppb
		Mishi, qumështi, vezët, produktet e akuakulturës, urina	0.15 ppb RPA
Chloramphenicol			
Nitrofurans	Metabolitet AMOZ, AHD, SEM, AOZ, DNSH	Mishi i shpendëve, produkte Akuakultura Muskuj/mish, qumësht, vezë	0.5 ppb RPA
Dapsone		Muskuj/mish Qumështi	5 ppb
Chlorpromazine		Veshka	5 ppb

* CCβ për metodat e shqyrtimit ose CCα për metodat konfirmuese dubet të jenë më të ulëta se vlera e shprehur në këtë kolonë.

** Për retinën ende nuk është e mundur të jepet një përqendrim i rekomanduar, pasi nuk është përcaktuar deri më tani se në cilën pjesë të syrit (ose i gjithë syri) dubet t'i referohet përqendrimi.

7. B2d Sedatives (EURL WFSR Wageningen)

Matrica e zgjedhur është veshka.

Substanca	Matrica	MMPR*
Carazolol Acepromazine Propiopromazine Azaperon/Azaperol	Haloperidol Veshka	5 ppb

* CCβ për metodat e shqyrtimit ose CCα për metodat konfirmuese dubet të jenë më të ulëta se vlera e shprehur në këtë kolonë.



8. NSAID B2e (EURL BVL Berlin)

Për qëllime kontrolli, matricat e zgjedhura janë muskujt dhe qumështi, të ndjekura nga veshkat, mëlçia dhe plazma.

Substanca	Matrica	MMPR*
Phenylbutazone Oxyphenbutazone	Muskujt Qumështi Veshkave Mëlçia Plazma	5 ppb
Ibuprofen Naproxen Mefenamic acid Niflumic acid Flufenamic acid		10 ppb

*CCβ për metodat e shqyrtimit ose CCa për metodat konfirmuese duhet të jenë më të ulëta se vlera e shprehur në këtë kolonë.

9. Substanca të tjera (EURL ANSES)

Substanca	Mbetjet e shënjestruara	Matrica	MMPR*
Malachite green	Malachite green dhe Leucomalachite green	Muskul Peshku	Shuma: 0.5 ppb RPA
Crystal violet (Gentian violet)	Crystal violet dhe Leucocrystal violet (Leucogentian violet)	Muskul Peshku	Shuma: 0.5 ppb RPA
Brilliant green	Brilliant green dhe Leucobright green**	Muskul Peshku	Shuma: 0.5 ppb RPA
Carbadox	QCA (quinoxaline- 2-carboxylic acid) dhe/ ose DCBX (Desoxycarbadox)	Muskul, Mëlçi	5 ppb
Olaquinox	MQCA (3-methylquinoxaline-2-carboxylic acid)	Muskul, Mëlçi	5 ppb

* CCβ për metodat e shqyrtimit ose CCa për metodat konfirmuese duhet të jenë më të ulëta se vlera e shprehur në këtë kolonë.

** Kontrolli i kësaj substance nuk është i detyrueshëm derisa të disponohet standardi i certifikuar i referencës.

10. Mjaltë (EURL ANSES Fougères për Antimikrobikët dhe BVL Berlin për Nitroimidazoles)

Grupi	Substancat që do të përfshihen	MMPR*
A6	Chloramphenicol	0.15 ppb RPA
	Nitroimidazoles	1 ppb
	Nitrofurans	0.5 ppb RPA
B1	Tetracyclines	10 ppb
	Sulfonamides	10 ppb
	Streptomycin	20 ppb
	Macrolides: Erythromycin Tylosin	20 ppb 10 ppb

* CCβ për metodat e shqyrtimit ose CCa për metodat konfirmuese duhet të jenë më të ulët se vlera e shprehur në këtë kolonë.

KËRKESË

Shtetasit Viktor Puka, Vangjeli Puka dhe Julian Puka, të tre të përfaqësuar me prokurorë të posaçme nga avokat Përparim Rama, kërkojnë

pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë shpalljen të zhdukur të shtetases Mariela Puka, e datëlindjes 3.9.1968, lindur në Tiranë.

KËRKUES
Viktor Puka, Vangjeli Puka, Julian Puka

*Shënim: Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë
të një procedure automatike nga një sistem elektronik
(Qendra e Botimeve Zyrtare)*

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2023

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 112 lekë